

Edlira Kraja është Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar, emëruar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.340, datë 22.4.2020.

Edlira Kraja është diplomuar Jurist, pasi ka kryer studimet për jurisprudencë, pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës (1999-2003). Më pas ka ndjekur studimet për Administrim Biznesi pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës (2007-2009) dhe është diplomuar në Master për Administrim Biznes.

Edlira Kraja, ka kryer ndër vite mjaft kurse kualifikimi që mbulojnë një pjesë të mirë të spektrit të Aviacionit Civil Ndërkombëtar.

Në vitet 2012-2014 ajo është diplomuar me “International Aviation Law Diploma”, specifikisht për “EU Aviation Law”, “International Aviation Law for Lawyers and Legal Professionals”, “Law on Aviation Insurance” dhe “Airline Contract Law”.

Me një eksperiencë pune 16-vjeçare, që fillon nga viti 2003 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil e më pas Autoriteti i Aviacionit Civil, Edlira Kraja ka një përvojë të gjerë dhe zotëron njohuri të plota dhe të thella në fushat kryesore të aktivitetit të këtij institucioni. Përgjatë këtyre viteve ajo ka kryer funksione menaxheriale në AAC, në disa nivele drejtimi, ku përfshihen Sektori Ligjor, ai i Kontratave, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Standardizimit Teknik.

Falë eksperiencës së saj në vite, në fushën e të Drejtës Publike Ndërkombëtare dhe Kombëtare të Ajrit, ajo ka luajtur një rol kyç në adaptimin dhe implementimin e instrumenteve juridike në fushën e transportit ajror civil shqiptar, ku spikat pozita si anëtare e grupit të ekspertëve që ka projektuar modifikimet që ka pësuar Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë.

Opinionet dhe kontributet janë evidentuar edhe në forumet e rretheve akademike ndërkombëtare ku trajtohen çështje të harmonizimit dhe implementimit të regjimeve juridike të aviacionit civil. Edlira Kraja ka përfaqësuar ndër vite Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar në disa organizma kombëtare dhe ndërkombëtare, si Koordinator i Shqipërisë për zbatimin e Marrëveshjes Shumëpalëshe për krijimin e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit, nga viti 2007 e deri tani; Anëtare e Njesisë së Zbatimit të Projektit në Marrëveshjen e Konçensionit për Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, nga viti 2008 e deri tani, Koordinator Kombëtar për ICAO-n gjatë vitit 2018, e të tjerë. Vlen për t’u përmendur roli aktiv në Grupet e Punës dhe Komisionet ad hoc; Çështje të tilla si mbrojtja e të drejtës së pasagjerëve, të shërbimeve Ground Handling, Plani Strategjik i zhvillimit të aeroporteve, modelet e privatizimeve etj. mbajnë gjithashtu kontributin e saj.